

29635

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. i aktit.....

V E N D I M
PËR RREGJISTRIM PERSONI JURIDIK

Sot me datë 05.2003, unë gjyqtarja _____ pasi studiova materialet e paraqitura nga Ortaku i Vetem **Behie Osmani**, për rregjistrim si person juridik te Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar " AUTOSERVIS OSMANI " Sh.p.k. Ortak i Vetem

KONSTATOVA

se Behie Osmani ka paraqitur një kërkesë, me të cilën kërkon rregjistrimin si person juridik të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar " AUTOSERVIS OSMANI " Sh.p.k. Ortak i Vetem.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

Import Eksport, Autoservis, pjese kembimi, tregtim me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industrial e ushqimore, artikuj te konsumit bujqesor e blegtoral, elektrike, elektronike, elektroshtepiake, tekstile, prodhime kimike edhe detergjente, materiale ndertimi; hidrosanitare, pesticide, bime medicinale, kozmetike, si dhe ne fushen e transportit te mallrave dhe te pasagjerve si brenda dhe jashte vendit.

Nga materialet që janë paraqitur, rezulton se veprimtaria e shoqërisë përputhet me kriteret e përcaktuara në Ligjin Nr. 7512, dt.10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", të Ligjit Nr. 7638, datë 11.11.1992, "Për shoqëritë tregtare", të Ligjit Nr.7667, dt. 28.1.1993 "Për rregjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare" dhe të akteve të tjera nënligjore që kanë dalë në zbatim të tyre. Për këtë arsye kërkesa e bërë për rregjistrimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

"AUTOSERVIS OSMANI" Sh.p.k., Ortak i Vetem, si person juridik duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

bazuar në nenet 3 e 5 të Ligjit Nr.7512, dt. 10.08.1991, neneve 12, 37 e vijues të Ligjit Nr. 7638, dt. 11.11.1992 dhe neneve 2 e 24 të Ligjit 7667, dt. 28.01.1993,

V E N D O S A

Pranimin e kërkesës.

Të rregjistroj shoqërinë " AUTOSERVIS OSMANI" Sh.p.k., Ortak i Vetem, si person juridik me seli ne Bajram Curri, dhe me objekt veprimtarie:

Import Eksport, Autoservis, pjese kembimi, tregtim me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale e ushqimore, artikuj te konsumit bujqesor e blegtoral, elektrike, elektronike, elektroshtepiake, tekstile, prodhime kimike, dhe detergjente, materiale ndertimi; hidrosanitare, pesticide, bime medicionale, kozmetike, si dhe ne fushen e transportit te mallrave dhe te pasagjerve si brenda dhe jashte vendit.


Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë.

Administratori i shoqërisë është Behie Osmani.

Kohëzgjatja e shoqërisë është 10 vjet.

Kundër vendimit lejohet të bëhet ankim në shkallë të dytë.

GJYQTARE



URDHER – REGJISTRIMI

1 2 9635

2 (a) Emertimi: "AUTOSERVIS OSMANI" Sh.p.k

(b) Selia: BAJRAM CURRI

(c) Objekti: Import, Eksport, Autoservis

(ç) Kapitali: 100.000 lekë

3. Administrator i shoqërisë Znj. Behie Osmani


Ortaket : Ortakësitet Behie Osmani

4. Statuti është nënshkruar me dt. 06.05.2005

5. Regjistruar me dt.

Mandat Arketimi

Gjyqtare
Ahmed Cepco





AKT THEMELIMI

i

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"AUTOSERVIS OSMANI" sh.p.k. (Ortak i Vetëm)

Personi që firmos më poshtë :

BEHIE OSMANI, e bija e Hamez dhe Butes, e datelindjes 23.03.1966 , lindur ne Bajram Curri, banuese ne Bajram Curri, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e cila për efekt të këtij akti themelimi, më poshtë do të quhet Ortak i Vetëm,

ne mbështetje te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 dhe Ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 ka hartuar, si më poshtë vijon, aktin e themelimit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar;

Neni 1

Ortaku i Vetëm ka krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, kontratën e themelimit dhe me dispozitat e statutit qe i bashkangjitet ketij akti.

Neni 2

Emertimi i i shoqërisë është **"AUTOSERVIS OSMANI" sh.p.k. (Ortak i Vetëm)**

Neni 3

Objekti i veprimtarisë se shoqërisë është :

Import - Eksport, Autoservis, pjese kembimi, tregtimi me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industrial e ushqimore, artikuj te konsumit bujqesor e blegtoral, elektrike, elektronike, elektroshtepiake, tekstile, prodhime kimike dhe detergjente, materiale ndertimi; hidrosanitare, pesticide, bime medicionale, kozmetike, si dhe ne fushen e transportit te mallrave dhe te pasagjerve si brenda dhe jashte vendit.

Neni 4

Shoqëria fiton personalitetin juridik dhe fillon veprimtarinë e saj pas rregjistrimit të saj në Gjykatën e rrethit Tiranë.

Neni 5

Selia e shoqërisë është në Bajram Curri.

Transferimi i shoqërisë në një adresë tjetër bëhet me miratimin e Ortakut të Vetëm.

Vendbanimi i Ortakut të Vetëm lidhur me raportet e tij me shoqërinë është ai që rezulton në rregjistrin tregtar.

Neni 6

Shoqëria mund të çelë filiale, degë dhe përfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë dhe në shtete të tjera. Njësitë strukturore të shoqërisë, filialet, degët dhe përfaqësitë e saj krijohen në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe atë të vendeve ku do të ngrihen.

Neni 7

Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar deri në vitin 2013, pra 10 vjet, duke filluar nga data e rregjistrimit të saj. Kjo periudhë mund të zgjatet tej afatit të mësipërm me miratimin e Ortakut të Vetëm.

Neni 8

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë, i cili është nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga ortakut i vetëm.

Neni 9

Shoqëria do të administrohet nga një administrator i vetëm e cila është . Znj.Behie Osmani.

Neni 10

Kohëzgjatja e shoqërisë caktohet për një afat kohe prej 10 vjetësh, pra deri në vitin 2013.

Shoqëria përgjigjet vetëm me pasurinë e saj për detyrimet kundrejt të tretëve.

Neni 11

Shoqëria ka vulën e saj. Ajo është e rrumbullaket me formën e zakonshme të vules, në të cilën është shkruar teksti "AUTOSERVIS OSMANI" Sh.p.k. dhe vëndndodhja e selisë së shoqërisë.

Neni 12

Dispozita më të hollësishme për funksionimin e shoqërisë caktohen në statutin e saj.

Neni 13


Ky akt themelimi hyn ne fuqi ditën qe nenshkruhet nga Ortaku Themelues.

Neni 14

Ky akt themelimi eshte hartuar ne Tirane, ne 4 ekzemplare, duke patur te gjitha tekstet te njejten fuqi ligjore.

ORTAKU THEMELUES

BEHIE OSMANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Nr. 1275 Rep.

Nr. 165 Kol.

V Ë R T E T I M

Sot me datë 06.05.2003 në zyrën e Noterisë Tiranë, para meje, notere në këtë qytet, u paraqit personalisht **Zonja BEHIE OSMANI ,e bija e**

Hamez dhe Butes, e datelindjes 23.03.1966, lindur ne Bajram Curri, banuese ne Bajram Curri, kombesi dhe shtetesi shqiptare, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, Ortak i Vetëm i Shoqërisë "AUTOSERVIS OSMANI" sh.p.k. me gjeneralitetet dhe adresën sa sipër, për identitetin e të ciles u sigurova nga Pasaporta me n.1942067, e cila më deklaroi se ka redaktuar jashtë kësaj zyre aktin e themelimit sa sipër, dhe e nënshkruan ate përpara meje, ndërsa unë noterja e vërtetoj sipas ligjit.

NOTE RE

Hatixhe Gojari
H

STATUT

i

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"AUTOSERVIS OSMANI" sh.p.k.
(Ortak i Vetëm)

Personi që firmos më poshtë :

BEHIE OSMANI, e bija e Hamez dhe Butes, e datelindjes 23.03.1966, lindur ne Bajram Curri, banuese ne Bajram Curri, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e cila për efekt të këtij statuti, më poshtë do të quhet Ortak i Vetëm,

ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 dhe Ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 ka hartuar, si më poshtë vijon, statutin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, të cilën ka vendosur ta themelojë, sipas kontratës së themelimit.

KREU I

FORMA, EMËRTIMI I SHOQËRISË, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 **Forma**

Ortaku i vetëm ka krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, kontratën e themelimit dhe me dispozitat e këtij statuti.

Neni 2 **Emërtimi i shoqërisë**

Emertimi i i shoqërisë është "AUTOSERVIS OSMANI" sh.p.k. (Ortak i Vetëm)

Neni 3 **Objekti i Veprimtarise**

Objekti i veprimtarisë se shoqërisë është :

Import - Eksport, Autoservis , pjese kembimi, tregtim me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industrial e ushqimore, artikuj te konsumit bujqesor e blegtoral, elektrike, elektronike, elektroshtepiake, tekstile, prodhime kimike dhe detergjente,

materiale ndertimi; hidrosanitare, pesticide, bime medicinale, kozmetike, si dhe ne fushen e transportit te mallrave dhe te pasagjerve si brenda dhe jashte vendit.

Neni 4 **Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik dhe fillon veprimtarinë e saj pas rregjistrimit të saj në Gjykatën e rrethit Tirane.

Neni 5 **Selia e Shoqërisë**

Selia e shoqërisë është në Bajram Curri.

Transferimi i shoqërisë në një adresë tjetër bëhet me miratimin e Ortakut të Vetëm.

Vendbanimi i Ortakut të Vetëm lidhur me raportet e tij me shoqërinë është ai që rezulton në regjistrin tregtar.

Neni 6 **Çelja e filjaleve, degëve dhe përfaqësive**

Shoqëria mund të çelë filiale, degë dhe përfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë dhe në shtete të tjera. Njësitë strukturore të shoqërisë, filialet, degët dhe përfaqësitë e saj krijohen në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe atë të vëndeve ku do të ngrihen.

Neni 7 **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar deri në vitin 2013, pra 10 vjet, duke filluar nga data e rregjistrimit të saj. Kjo periudhë mund të zgjatet tej afatit të mësipërm me miratimin e Ortakut të Vetëm.

KREU II **KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESËT E KAPITALIT** **THEMELTAR**

Neni 8 **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë, i cili është nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga ortaku i vetëm.

Neni 9

Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit

Ortaku i Vetëm nuk kufizohet në rritjen e kapitalit themeltar.
Zvogëlimi i kapitalit themeltar behet nga ortaku i vetem deri ne kuoten limit qe e lejon ligji.

Neni 10

Afatet dhe mënyrat e vendosjes së kapitalit

Kapitali në para është paguar tashmë dhe është depozituar në Bankën e Kursimeve, në një llogari të hapur në emër të shoqërisë.

Neni 11

Transferimi i kapitalit themeltar

Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm nga Ortaku i Vetëm tek të tretët dhe me rrugë trashëgimie, në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve si dhe ndërmjet paraardhësve e pasardhësve.

KREU III

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKUT TË VETËM

Neni 12

Të drejtat

Ortaku i Vetëm gëzon këto të drejta kryesore :

- * Drejtimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me kontratën e themelimit dhe këtë statut.
- * Pjesmarrjen në rezultatet e çdo forme e sasi të veprimtarisë së shoqërisë.
- * Emërimin e Administratorit dhe të ekspertit kontabël.
- * Marrjen e të dhënave që kanë të bëjnë me gjëndjen ekonomiko-tregtare dhe me llogaritë ekonomike.
- * Paraqitjen e kërkesave, vërejtjeve e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Ortaku Vetëm sipas këtij statuti.
- * Transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar personave të tretë.
- Miratimi i llogarive te paraqitura nga eksperti kontabel.

Neni 13

Detyrat

Ortaku i Vetëm ka këto detyra kryesore :

- * Të marrë pjesë në drejtimin e shoqërisë si dhe në administrimin e saj, sipas këtij statuti.
- * Të emërojë organet përkatëse.

* Ne baze te te dhenave te grumbulluara te perpunoje objektivat qe lidhen me veprimtarine e shoqerise.

* Të kryejë detyrat për realizimin e objektit dhe të funksioneve të shoqërisë.

KREU IV MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE

Neni 14

Marrja e vendimeve nga Ortaku i Vetëm.

I vetmi organ vendimor i shoqerise eshte Ortaku i Vetem.Vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm evidentohen në një regjistër i cili mbahet nga administratori i shoqerise.

Neni 15

Administrimi

Shoqëria administrohet nga një administrator që është **znj. Behie Osmani**.

Emërimi i administratorit bëhet për një kohëzgjatje prej 3 vjetësh financiare, me të drejtë ripërtëritje, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm. Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë dhe ndaj të tretëve për shkelje ligjore, për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij.

Neni 16

Kopetencat e administratorit

Administratori ka në kopetencë :

- Administrimin e zakonshëm të shoqërisë, me përjashtim të kopetencave taksative te Ortakut te Vetem.
- Miratimin e planeve dhe llogarive ekonomike periodike.
- Propozimin e ndryshimit të kapitalit.
- Përcaktimin e rregjimit dhe kushteve të llogarisë ekonomike,
- Hartimin e rregullave të brendëshme të shoqërisë dhe të personelit.
- Hartimin e organikës së personelit.
- Paraqitjen e propozimeve Ortakut të Vetëm për përdorimin e fondeve dhe likuidimin e borxheve.
- Ndarjen e detyrave ndërmjet strukturave organizative të shoqërisë.

Administratori ngarkohet për të kryer të gjitha veprimet juridike me të tretët në emër të shoqërisë. Sa siper Administratori ja paraqet per miratim Ortakut te V etem.

Neni 17

Ekspertët kontabël të autorizuar

Kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i emëruar për tre vite financiare, me mundësi rizgjedhjeje. Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar

vendoset në të njëjtat kondita si emërimi, në rast se kryhen shkelje, vërehen gabime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

KREU V

VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE, NDARJA E FITIMEVE, REZERVA E DOMOSDOSHME

Neni 18

Viti financiar, llogaritë vjetore

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e shoqërisë në Gjykatë dhe përfundon me 31 Dhjetor 2002. Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga Administratori dhe nga eksperti kontabël i autorizuar miratohen nga Ortaku i Vetëm. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brënda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar. Bilanci duhet t'i paraqitet për aprovim Ortakut të Vetëm deri në muajin Shkurt të vitit pasardhës.

Neni 19

Rezervat e domosdoshme

Shoqëria, nga fitimi i realizuar gjatë vitit financiar, pasi të jenë zbritur po të jetë e nevojshme humbjet e vitit të mëparshëm, rezervon një shumë me vlerë të paktën 1/10 të tij, e cila destinohet për fondin rezervë të domosdoshëm.

KREU VI

ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA DHE LIKUJDIMI

Neni 20

Zgjatja e afatit

Me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 7 të këtij statuti, zgjatja e tij mund të vendoset nga Ortaku i Vetëm.

Neni 21

Likujdimi

Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Ortaku i Vetëm emëron një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin atij raportin mbi gjëndjen e arkivit dhe pasivit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre. Në fund të këtij procesi, Ortaku i Vetëm vendos për bilancin përfundimtar, për aktin e rregullshmërisë së punës së likujduesit e për heqjen e mandatit të likujdimit. Pas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar tek kontribuesit përkatës, kapitali i mbetur i takon Ortakut të Vetëm.

Neni 22

Çështjet që nuk trajtohen në këtë statut rregullohen sipas legjislacionit përkatës shqiptar.

Neni 23

Ky statut është hartuar në Tiranë, Shqipëri në 4 ekzemplarë origjinalë në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha tekstet të njëjtën fuqi ligjore.

ORTAKU I VETËM

BEHIE OSMANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Nr. 1276 Rep.


Nr. 166 Kol.

V È R T E T I M

Sot me datë 06.05.2003 në zyrën e Noterisë Tiranë, para meje, notere në këtë qytet, u paraqit personalisht **Zonja BEHIE OSMANI**, e bija e Hamez dhe Butes, **e datelindjes 23.03.1966, lindur ne Bajram Curri, banuese ne Bajram Curri, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar**, Ortak i Vetëm i Shoqërisë "AUTOSERVIS OSMANI" sh.p.k. me gjeneralitetet dhe adresën sa sipër, për identitetin e të ciles u sigurova nga Pasaporta me n. 1942067, e cila më deklaroi se ka redaktuar jashtë kësaj zyre statutin sa me sipër, dhe e nënshkruan ate përpara meje, ndërsa unë noterja e vërtetoj sipas ligjit.

NOTERE

Ma fexhe *Behie Osmani*



KËRKESË

3 A Copo
02 08 2003
[Signature]

KËRKUES : Behie Osmani, e bija e Hamez dhe Butes, e datelindjes 23.03.1966 , lindur ne Bajram Curri në Bajram Curri, me zotesi te plote juridike per te vepruar, e madhore, me kombesori, i identifikuar me nr. Pas, 1942067.

Rregjistrimin si person juridik të Shoqërisë Tregtare "**AUTOSERVIS** OSMANI" Sh.p.k. (Ortak i Vetem) në bazë të neneve 13 e 19 të Ligjit Nr. 7632, dt. 19.11.1992, ve 6 e 37 e vijuesa të Ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992, nenit 2, 24 e 26 të Ligjit Nr. 7638, datë 28.01.1993.

GJYKATËS SË SHKALLES SE PARE TIRANË

U themelues i vetem themelues i shoqërisë "**AUTOSERVIS OSMANI**" Sh.p.k. Behie Osmani, kërkoj nga ana e kësaj Gjykate të tregjistrojë si person juridik me Përgjegjësi të Kufizuar "**AUTOSERVIS OSMANI**" Sh.p.k. me identifikuesi të Kufizuar. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

Autoservis , pjese kembimi, tregtim me shumice e pakice te artikujve te ndryshemore, artikuj te konsumit bujqesor e blegtoral, elektrike, elektronike, elektroshtepia, kimike dhe detergjente, materiale ndertimi; hidro-sanitare, pesticide, bime medicinale ne fushen e transportit te mallrave dhe te pasagjerëve si brenda dhe jashte vendit.

Capitali i shoqërisë është 100.000 lekë.

Themeluesi i shoqërisë dhe administrator është Behie Osmani.

Edheqimi i shoqërisë është 10 vjet.

Bashkëlidhur kësaj kërkesë ju paraqesim dhe aktet e themelimit të shoqërisë, kontratën dhe statutin e saj, si dhe mandat pagesën e derdhjes së kontributit në lek për themelimin e kapitalit themeltar.

I lutemi kësaj Gjykate të pranojë kërkesën për rregjistrim si person juridik të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar " **AUTOSERVIS OSMANI**" Sh.p.k. (Ortak I Vetem)

KËRKUES Ortaku Themelues
Behie Osmani

Behie

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Nr. 1274 Rep.
Nr. — Kol.

V È R T E T I M

Sot me datë 06.05.2003, në zyrën e Noterisë Tiranë, para meje, notere në këtë qytet, u para personalisht **Zonja Behie Osmani**, e bija e Hamez dhe Butes, e datelindjes 23.03.1966, lindur Bajram Curri, banuese ne Bajram Curri, me zotesi te plote juridike per te vepruar, e madhore, kombesi e shtetesi shqiptare,i identifikuar me nr. Pas. 1942067, Ortak i Vetëm dhe Administrato Shoqërisë "AUTOSERVIS OSMANI" sh.p.k. me gjeneralitetet dhe adresën sa me sipër, për identitetin e ciles u sigurova nga Pasaporta, e cila më deklaroi se ka redaktuar jashtë kësaj zyre kerkesen sa me sip dhe e nënshkruan ate përpara meje, ndërsa unë noterja e vërtetoj sipas ligjit.

NOTERE

Helixhe Gogani

